




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS  
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), neni 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës nxjerr këtë

### V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve si subvencion për blerjen e drunjëve për ngrohje, për 201 (dyqind e një) familje me asistencë sociale.
- II. Shuma e mjeteve financiare do të jetë gjithsej 27,135.00 € (njëzet e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë euro), nga 135 € (një qind e tridhjetë e pesë euro) për çdo familje, për blerjen e 3m<sup>3</sup> dru për ngrohje, me çmimet aktuale të tregut.
- III. Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, do të derdhet në xhironlogaritë bankare të çdo familje, sipas listës të përgatitur nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, e cila do të jetë pjesë e këtij vendimi.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

#### U dorëzohet:

- Drejtorisë së Mirëqenies Sociale;
- Drejtorisë së Financave;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti